



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTEN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 476/5 Prot.

Tiranë, më 26/5/2016

V E N D I M

Nr. 27, datë 26/5/2016

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Ligjit nr. 8485, datë 12/05/1999 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", të procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Easy Invest*" *Sh.p.k*, Tiranë.

VËREJ SE :

Në zbatim të Urdhrit nr. 103, datë 22/04/2016, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit e Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit, "*Easy Invest*" *Sh.p.k* (Nipt L61424017H), me objekt:

- Zbatimi nga ana e kontrolluesit i Ligjit Nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij.

Gjatë veprimtarisë së tij kontrolluesi përpunon të dhëna për kategoritë e subjekteve "Klientë" dhe "Punëmarrës". Për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Klientë" përpunohen të dhëna personale: emër, mbiemër, nr.telefoni dhe adresë e-maili.

Për kategorinë e subjekteve të të dhënave "Punëmarrës", kontrolluesi përpunon të dhëna personale: Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër), vendlindje, datëlindje, numrin e sigurimit shoqëror, adresa dhe numër personal i identifikimit, nëpërmjet administrimit të dokumenteve në dosjen e punës, për qëllime të menaxhimit të burimeve njerëzore dhe në zbatim të detyrimeve ligjore (Kodi i Punës).

1. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi "*Easy Invest*" *Sh.p.k* gjatë ushtrimit të aktivitetit financiar realizon marketing të drejtpërdrejtë ndaj subjekteve të të dhënave nëpërmjet telefonit. Në thirrjet e kryera prej tij konstatohet prania e numrave të celularit të qytetarëve, të regjistruara manualisht në blloqe individuale të operatorëve të kontrolluesit, për të cilat kontrolluesi deklaroi se nuk kishte marrë pëlqimin e tyre për t'u kontaktuar sipas nenit 3 pika 24 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, duke vepruar në kundërshtim me nenin 6 pika 1/a të këtij të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit vlerëson se pëlqimi i subjekteve të të dhënave personale është e vetmja mundësi ligjore e kontrolluesit për të legjitimuar përpunimin e të dhënave personale, kjo pasi nuk konstatohen kritere të tjera të ligjshme përpunimi nga ana e kontrolluesit. Në çdo rast pëlqimi duhet të jepet me vullnetin e lirë dhe duhet të jetë i provueshëm (në formë shkresore) në bazë të nenit 3 pika 24 të ligjit. Për sa kohë kontrolluesi nuk ka mundur të provojë ekzistencën e pëlqimit dhe ka deklaruar se nuk e ka marrë atë, vlerësojmë se përpunimi i të dhënave është i paligjshëm, duke cënuar edhe parimin e sanksionuar në nenin 5/1/a të ligjit.

2. Në kuadër të zbatimit të detyrimit për informim, neni 18 i Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, Zyra e Komisionerit konstatoi se në faqen online të administruar nga kontrolluesi, subjektet e të dhënave (klientët) mund të regjistrohen duke plotësuar të dhënat (emër, mbiemër, nr.telefoni, adresë email), për të marr akses në platformën (programin) kur zhvillohet investimi për tregun e bursave. Klienti më pas, logohet në këtë program me numër dhe fjalëkalim.

Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk i informon subjektet e të dhënave personale, mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave dhe masat e sigurisë. Në faqen e internetit të kontrolluesit nuk janë të parashikuara *“politikat e privatësisë”*.

Në frymën e ligjit, çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes online në internet, ka detyrimin që të publikojë *“politikat e privatësisë”*, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes online në internet.

Zyra e Komisionerit vlerëson se mospublikimi i *“politikave të privatësisë”* në faqen e internetit, privon subjektet e të dhënave personale nga e drejta për informim (në bazë të nenit 18) dhe të drejtat e parashikuara në kreun IV *“Të drejtat e subjektit të të dhënave”*, të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, duke mos u dhënë mundësi në ushtrimin e tyre dhe duke i cënuar ato.

3. Nga verifikimi paraprak i kryer në regjistrin elektronik të KDIMDP-së dhe në protokollin e Zyrës së Komisionerit si edhe nga hetimi administrativ i ushtruar rezultoi se kontrolluesi nuk e kishte përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

Në paragrafin 1, të nenit 21 të ligjit, parashikohet:

“Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim është i rëndësishëm pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen mbi përpunimin që kryen kontrolluesi dhe realizimin e detyrimeve ligjore. Kjo i jep mundësi reale subjektit të të dhënave për të ushtruar në mënyrë korrekte të drejtat që i jep ligji.

4. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi përpunon të dhëna nëpërmjet sistemit të video survejimit CCTV, me qëllim garantimin e sigurisë së ambienteve të brendshme. Kontrolluesi ka marrë masa për informimin e subjekteve të të dhënave nëpërmjet, *“tabelave informuese”* në përputhje me modelin standard të përcaktuar nga Komisioneri në Udhëzimin nr. 3 *“Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*.

Sistemi i video-survejimit i instaluar në ambientet e kontrolluesit përbëhet nga 3 kamera. Regjistrimet ruhen për një periudhë 2 javore, kufizuar dhe nga kapaciteti i pajisjes regjistruese. Aksesit në ndërfaqen e administrimit të sistemit CCTV është i mbrojtur me fjalëkalim, por kontrolluesi nuk ka marrë masa për të caktuar një person përgjegjës për administrimin e këtij sistemi.

Megjithatë, konstatojmë se kontrolluesi ka reaguar duke përcaktuar punonjës të përgjegjës për administrimin dhe kontrollin e sistemit të video survejimit CCTV .

5. Zyra e Komisionerit konstatoi se kontrolluesi nuk kishte hartuar një *“Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”* në të cilën të parashikohen rregulla specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave të klientëve dhe punonjësve, sigurinë e të dhënave, afatet e mbajtjes së të dhënave, të drejtat e subjekteve, etj, në kundërshtim me nenin 27 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar.

Hartimi i rregullores është i rëndësishëm për kontrolluesin pasi përbën bazën e referimit për çdo përpunim të të dhënave, për çdo punonjës dhe përcakton standardet ligjore për garantimin e një përpunimi të ligjshëm dhe të sigurtë të të dhënave personale. Rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse (të përfshijë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale për çdo kategori subjektësh të të dhënave).

Gjatë zhvillimit të hetimit administrativ kontrolluesi hartoi dhe vuri në dispozicion të grupit të hetimit një aneks rregullore mbi *“Mbrojtjen Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale”*.

Për shkeljet e konstatuara është mbajtur procesverbali i konstatimit, si dhe në respektim të së drejtës për t’u dëgjuar, në zbatim të neneve 93-96 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 *“Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”*, në datë 19/05/2016 është mbajtur seanca dëgjimore me përfaqësuesin e kontrolluesit lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përpara marrjes së vendimit përfundimtar. Kontrolluesi ka depozituar pretendime nëpërmjet shkresës nr. 001/1 prot, datë 09.05.2016 *“Kthim përgjigje mbi Proces-Verbalin e Hetimit Administrativ”* (kopje së cilës është administruar në dosjen hetimore në cilësinë e provës).

Kontrolluesi gjatë seancës dëgjimore deklaroi që i përmbahet asaj çfarë kishte deklaruar në shkresën drejtuar Komisionerit në lidhje me shkeljet e konstatuara në procesverbalin e hetimit administrativ. Në tërësi kontrolluesi nuk i ka kundërshtuar konstatimet e Komisionerit por i ka qëndruar deklarimit se kompania ka shumë pak kohë që ka filluar aktivitet dhe mangësitë kanë ardhur si pasojë e mosnjohjes së ligjit. Zyra e Komisionerit vlerëson se ky pretendim nuk përbën shkak për mospërbushjen e detyrimeve ligjore dhe përjashtimin nga përgjegjësia.

Kontrolluesi "Easy Invest" Sh.p.k është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit më datë 24.02.2016, hetimi administrativ pranë këtij kontrolluesi filloi në datën 03/05/2016, kontrolluesi ka pasur kohë të mjaftueshme për të përmbushur detyrimet ligjore mbi përpunimin e të dhënave.

Në nenin 21, të ligjit të sipërcituar, parashikohet qartësisht ky detyrim "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit...".

Për më tepër, detyrimin ligjor për të njoftuar kontrolluesi nuk e ka përmbushur edhe gjatë kohës që kishte në dispozicion që nga momenti i mbajtjes së procesverbalit të konstatimit (06.05.2016) deri në ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore (19.05.2016).

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ në kuptim të nenit 39/1 shkronjat "a", "b" dhe "d", të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "*Përpunimi i të dhënave personale*", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;

Kontrolluesi "Easy Invest" Sh.p.k, në formën ligjore të aktivitetit të tij tregtar është person juridik dhe sipas nenit 39/2 të Ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze, ato lidhen me garantimin e përpunimit të ligjshëm të të dhënave, të drejtën e subjekteve të të dhënave për t'u informuar mbi përpunimin e të dhënave të tyre, detyrimin për njoftim pranë Zyrës së Komisionerit në zbatim të ligjit. Gjithashtu, bazohet në bashkëpunimin gjatë ushtrimit të hetimit administrativ si dhe reagimin e kontrolluesit për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 6/1/a, 18, 21, 29, 30, 31, 39/1/a, 39/1/b dhe 39/1/d, 39/2, 40 dhe 41 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Dënimin e kontrolluesit "Easy Invest" Sh.p.k me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 6/1/a të Ligjit nr.9887, datë 10/03/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

2. Dënimin e kontrolluesit "Easy Invest" Sh.p.k me gjobë, në vlerën **50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "Easy Invest" Sh.p.k me gjobë, në vlerën **100 000 (njëqind mijë) lekë** për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 21 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga zyra e përmbarimit.
5. Kontrolluesi "Easy Invest" Sh.p.k, të pezullojë menjëherë përpunimin e të dhënave personale që zhvillon përmes marketingut të drejtpërdrejtë dhe të realizojë seleksionimin dhe klasifikimin tyre si:
 - Të dhëna personale të siguruara në rrugë të drejtë e ligjore,
 - Të dhëna personale të siguruara në mënyrë jo të drejtë dhe të paligjshme.
6. Kontrolluesi "Easy Invest" Sh.p.k, pasi të ketë vepruar sipas pikës 5 të këtij vendimi, duhet të realizojë shkatërrimin e të gjitha të dhënave personale të siguruara në mënyrë jo të drejtë dhe të paligjshme.
7. Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit nr. 9887, datë 10/03/2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i ndryshuar, të kryhet plotësimi i detyrimeve të parashikuara në pikat 5 dhe 6 të këtij Vendimi, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni. Pas këtij afati të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale mbi masat e marra në zbatim të detyrimeve të lëna.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij vendimi.

Ky vendim u shpall sot më datë 26, 5 2016.

